



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**Ac.nr.10346/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Milena Djerić e Rafet Haxhaj – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses “.....” Banka Sh.A., me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga C.L., me adresë në Prishtinë “.....” nr.31/1/1, kundër të paditues F.P. nga fshati ..... Komuna e Mitrovicës rr. “.....”, p.nr., të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj av. B. K. nga Mitrovica, për shkak të borxhit, me propozim për caktimin e masës së përkohshme, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.1054/2020, të datës 22.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 29.12.2021, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditëses “.....” Banka Sh.A., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.1054/2020, i datës 22.09.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar C.nr.1054/2020, të datës 22.09.2021, e ka hedhur padinë e paditëses, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, “.....” Bankë me seli në Prishtinë, kundër të paditues F.P., për shkak të borxhit, si të pa lejuar.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, paditësja ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën e saj dhe aktvendimin e ankimuar ta prish, apo që çështjen ta kthejë në rivendosje pranë gjykatës së shkallës së parë.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e paditëses.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e paditëses, është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me datën 08.10.2020, pranë gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurve N.P. dhe F.P., për realizimin e borxhit, me propozim për caktimin e masës së përkohshme, më gjerësisht sikurse në padi. Në ndërkohë, përmes parashtrësës së datës 13.09.2021, paditësja e ka tërhequr padinë ndaj paditësit të parë N. P., me arsye sikurse në këtë parashtrësë, ndërsa ka propozuar që procedura të zhvillohet vetëm ndaj të paditurës F.P.

Gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar C.nr.1054/2020, të datës 22.09.2021, me të cilin e ka hedhur poshtë padinë e paditëses si dhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme, sikurse në dispozitiv të tij. Në arsyetim të aktvendimit, gjykata në fjalë ka theksuar se në rastin konkret ka marrë për bazë dispozitën e nenit 391 par.1 pika e) dhe pika d) të LPK, ku është paraparë se pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se për objektin e kontestit është lidhur ujdia gjyqësore, se paditësi ka hequr dorë nga kërkesëpadia, se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi, gjersa në pikën d) është paraparë që padia do të hidhët kur çështja është e gjykuar (res iudicata). Sipas gjykatës së shkallës së parë, paditësja në rastin konkret nuk ka interes juridik për udhëheqjen e procedurës kontestimore, e kjo pasi që në bazë të shkresave të lëndës është provuar se në ndërkohë është udhëhequr edhe procedurë përmbarimore dhe është nxjerrur aktvendimi CPP.nr.105/2017, i datës 08.02.2018, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 09.03.2018, e përmes të cilit këtu e paditura (në atë procedurë debitorja) F.P. nga fshati ..... komuna e Mitrovicës, është obliguar që kreditores ..... Banka me seli në Prishtinë, t'ia paguaj shumën e borxhit prej 14.319,15 euro. Nga kjo arsyeje gjykata e shkallës së parë padinë e saj me propozim për caktimin e masës së sigurisë, e ka hedh si të pa lejuar, pasi që në rastin konkret pala paditëse nuk ka më interes juridik për të zhvilluar procedurë kontestimore ndaj tani të paditurës, duke qenë se borxhi i kërkuar është jokontestues dhe se këtu pala e paditur është obliguar ta paguaj këtë borxh me aktvendim të plotfuqishëm të cekur si më lartë. Me rastin e vendosjes gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka bazuar në nenin 391 par.1 pika e) dhe pika d) të LPK.

Gjykata e Apelit e Kosovës, e pranon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është i kjashtë dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të

vendosë si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktvendimit.

Me nenin 391 të LPK parashihet se *“pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se, ndër të tjera, çështja është gjë e gjykuar (res iudicata)”*. Në rastin konkret, siç edhe ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, paditësja nuk ka interes juridik për zhvillimin e procedurës ndaj këtu të paditurës, pasi që është provuar se në ndërkohë është udhëhequr edhe një procedurë përmbartimore dhe është nxjerrur aktvendimi CPP.nr.105/2017, i datës 08.02.2018, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 09.03.2018, e përmes të cilit këtu e paditura (në atë procedurë debitorja) F.P. nga fshati .... komuna e Mitrovicës, është obliguar që kreditores .... Banka me seli në Prishtinë, t’ia paguaj shumën e kërkuar prej 14.319,15 euro. Pra në rastin konkret për borxhin e kërkuar të paditëses tani më është vendosur në favor të saj dhe ky borxh është në realizim e sipër në procedurën përmbartimore, për çka edhe del se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka hudhur poshtë padinë e paditëses, bashkë me propozimin për caktimin e masës së përkohshme.

Në raport me masën e përkohshme të propozuar, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se propozimi në fjalë është i lidhur me padinë dhe përderisa padia e paditëses në rastin konkret është hudhur poshtë, për arsye të cekura si më lartë, atëherë del se propozimi për caktimin e masës së përkohshme është inekzistent për këtë çështje kontestimore. Për më tepër, sipas dispozitës së nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se *“masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit”*. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadisë. Mbi bazën e rrethanave të cekura si më lartë, del se në rastin konkret nuk kanë qenë të plotësuara as kushtet për caktimin e masës së sigurimit për shkak se paditësja tani më është në realizim e sipër të borxhit të saj ndaj të paditurës, në procedurën përmbartimore, e cila si e tillë është procedurë urgjente dhe e cila është përfunduar me vendim të plotëfuqishëm të lartcekur të gjykatës. Mbi bazën e të lartëcekurave edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesën e paditëses, por ka gjetur se të njëjtat janë të pathemelta dhe se nuk kanë pasur ndikim që gjykata të merrë një vendim ndryshe.

Nga të cekurat si më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.10346/2021, me datën 29.12.2021**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Valon Totaj**